

20251963996

Mbështetur në nenin 15 paragrafi (3) të Ligjit për financimin kapital të detyrueshëm të sigurimit pensional (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018 dhe 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019, 103/2021, 86/2025 dhe 114/2025) dhe në nenin 26 paragrafi (3) të Ligjit për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 07/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 103/2021), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë për Mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2025, miratoi:

RREGULLORE

PËR KUSHTET E DETAJUARA PËR THEMELIMIN E SHOQËRIVE PENSIONALE

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më në detaje kushtet për themelimin e shoqërive për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale të përcaktuara me nenet 14 dhe 15 të Ligjit për financimin e kapital të detyrueshëm të sigurimit pensional, si dhe kushtet për themelimin e shoqërive për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale nga nenet 24, 25 dhe 26 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional, nga persona juridikë vendas dhe të huaj.

Neni 2

Shoqëria për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale, shoqëria për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale dhe shoqëria për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin vijues: shoqëri pensionale) mund të themelohet nga një person juridik ose nga një grup personash juridikë – vendas ose të huaj, në përputhje me Ligjin për financimin kapital të sigurimit pensional dhe Ligjin për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional.

Neni 3

51% ose më shumë e kapitalit themeltar të shoqërisë pensionale zotërohet nga një person juridik ose një grup personash juridikë që veprojnë së bashku, në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 4

1. Kur themelues i një shoqërie pensionale është një person juridik i vetëm, ai duhet të ketë kapital dhe/ose mjete vetjake në shumën dhe kushtet e përcaktuara me ligj, sipas natyrës dhe veprimtarisë së themeluesit; kur është grup personash juridikë, secili person juridik i grupit duhet të ketë kapital dhe/ose mjete vetjake në shumën dhe kushtet e përcaktuara me ligj, sipas natyrës dhe veprimtarisë së tij.

2. Shuma e kapitalit ose e mjeteve vetjake duhet të konfirmohet nga një auditor i jashtëm i autorizuar.

3. Si auditorë të jashtëm të autorizuar, në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni, konsiderohen: Deloitte and Touche, Ernst and Young, KPMG dhe PricewaterhouseCoopers.

Neni 5

1. Personi juridik ose grupi i personave juridikë themelues të shoqërisë pensionale duhet të ketë një ekip menaxherial të përhershëm (organ drejtues), i përbërë nga persona kompetentë, profesionistë dhe me përvojë, që përfshin edhe persona përgjegjës për: çështje juridike, auditim të brendshëm, marketing, menaxhim të mjeteve dhe kontabilitet.

2. Me persona kompetentë, profesionistë dhe me përvojë, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen ata persona që kanë:

a) arsim të lartë, përkatësisht ciklin e parë të studimeve sipas ECTS nga një institucion i akredituar i arsimit të lartë; dhe

b) të paktën pesë vite përvojë relevante të lidhur me menaxhimin e fondeve pensionale, në shoqëri për menaxhimin e mjeteve, banka, shoqëri sigurimesh ose shoqëri të tjera financiare; ose tre vite përvojë pune si person me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme në institucionet e sipërpërmendura.

Neni 6

Kur themelues është një institucion financiar i huaj, vlerësimi i kredisë duhet të jetë i lëshuar nga një prej agjencive ndërkombëtare të njohura të vlerësimit të kredisë: Moody's Investor Services, Inc. ("Moody's"), Standard & Poor's Corp. ("S&P") ose Fitch IBCA ("Fitch").

(2) Përveç agjencive të paragrafit (1) të këtij neni, si agjenci ndërkombëtare të njohura të vlerësimit të kredisë konsiderohen edhe:

a) A.M. Best Co. ("Best"), kur bëhet fjalë për shoqëri sigurimi; dhe

b) Dun & Bradstreet, kur bëhet fjalë për institucione të tjera financiare ose persona juridikë.

Neni 7

Nëse ndodh ndryshim në marrëdhëniet e përcaktuara me nenin 14 paragrafët (3) dhe (4) të Ligjit për financimin kapital të sigurimit pensional dhe nenin 24 paragrafët (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) të Ligjit për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional, përkatësisht nëse:

a) ndonjë nga themeluesit e një shoqërie për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale bashkohet ose kryen tjetër ndryshim statusor me themelues të një shoqërie tjetër për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale, pas dhënies së lejes për themelim dhe miratimit për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale, ai themelues:

- menjëherë njofton Agjencinë për Mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (në tekstin vijues: Agjencia) për bashkimin ose ndryshimin tjetër statusor;

- shet të gjitha aksionet e veta në një nga shoqëritë për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale kur ekzistojnë vetëm dy shoqëri të tilla, brenda gjashtë muajve pas bashkimit ose ndryshimit statusor, në përputhje me Ligjin për financimin kapital të sigurimit pensional; dhe

- shet të gjitha aksionet e veta në një nga shoqëritë për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale ose bashkon të dy shoqëritë dhe të dy fondet e detyrueshme pensionale, nëse ekzistojnë më shumë se dy shoqëri të tilla, brenda gjashtë muajve pas bashkimit ose ndryshimit statusor, në përputhje me Ligjin për financimin kapital të sigurimit pensional.

b) ndonjë nga themeluesit e një shoqërie për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale bashkohet ose kryen tjetër ndryshim statusor me themelues të një shoqërie tjetër për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale, pas dhënies së lejes për themelim dhe miratimit për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale, ai themelues:

- menjëherë njofton Agjencinë për bashkimin ose ndryshimin tjetër statusor; dhe

- shet të gjitha aksionet e veta në një nga shoqëritë për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale ose i bashkon shoqëritë për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale dhe vetë fondet vullnetare pensionale, brenda gjashtë muajve pas bashkimit ose ndryshimit statusor, në përputhje me Ligjin për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional.

c) ndonjë nga themeluesit e një shoqërie për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale bashkohet ose kryen tjetër ndryshim statusor me themelues të një shoqërie tjetër të tillë, pas dhënies së lejes për themelim dhe miratimit për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, ai themelues:

- menjëherë njofton Agjencinë për bashkimin ose ndryshimin tjetër statusor; dhe
- shet të gjitha aksionet e veta në një nga shoqëritë për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale ose i bashkon shoqëritë për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe vetë fondet, brenda gjashtë muajve pas bashkimit ose ndryshimit statusor, në përputhje me Ligjin për financimin kapital vullnetar të sigurimit pensional.

Neni 8

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për kushtet e detajuara për themelimin e shoqërive pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/2008, 154/2010 dhe 45/2011).

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 01-1151/5

4.9.2025

Shkup

Kryetari i Këshillit të

Ekspertëve,

Remzi Bajrami, d.v.